

Tiranë më, 09.04.2026

Shtojca nr. 1

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR TENDERIN E RIPARIMIT TË AUTOMJETEVE TË SHOQATËS SOS FSHATRAT E FËMIJËVE SHQIPËRI.

Objekti, qëllimi dhe informacion teknik të shërbimeve të kërkuara:

1. Plotësimi i nevojave për shërbimet e riparimeve të automjeteve të Organizatës SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri sipas zërave të punimeve të kerkuara përkatësisht në shtojcen nr.2.
2. Në asnjë rast servisi (fituesi i tenderit) nuk do të pranojë të riparojë automjetet e Organizatës SOSFF, pa pasur një email të personit që është ngarkuar për ndjekjen e kontratës.
3. Kur automjeti mbërrin në servis (fitues i tenderit) për të përfutur shërbimin e riparimit, bëhet menjëherë identifikimi i difekteve, për të cilat ka nevojë automjeti, duke u shoqëruar me proces-verbal, për përcaktimin e zërave të punës, mbi të cilin do të kryhet riparimi i tij (proces-verbali nr.1 bashkëngjitur). Këto identifikime gjithashtu dërgohen me email paraprakisht te personi i autorizuar për ndjekjen e kontratës nga i cili duhet të marrë një konfirmim për vijimin e procesit të riparimit. Për Organizatën SOSFF proces verbali do të firmoset nga drejtuesi i mjetit i cili është prezent gjatë procesit të identifikimit te difekteve.
4. Në përfundim të riparimit përpilohet proces-verbali përfundimtar mbi kryerjen e punimeve të shërbimit, i cili firmoset nga personit që është ngarkuar për ndjekjen e kontratës, drejtuesi i mjetit të riparuar dhe përfaqësuesi i servisit-fitues i tenderit (proces-verbali nr.2 bashkëngjitur).
5. Cdo faturë shërbimi duhet të shoqërohet me fletën e garancisë ku të dokumentohet qartë data e fillimit dhe mbarimit të garancisë (për zëvendësim me pjesë të reja garancia është të paktën 1 vit).
6. Për mjetin e paraqitur në servis (fitues i tenderit), për kryerjen e nevojave të shërbim-riparimeve, shërbimi duhet të fillojë jo më vonë se 24 orë nga koha e paraqitjes së automjetit për riparim.
7. Koha maksimale e qëndrimit të automjetit për riparim nuk duhet të kalojë 10 ditë kalendarike.
8. Në qoftë se automjetit në riparim i duhet të qëndrojë më tepër se 10 ditë kalendarike, atëherë operatorit fitues të tenderit i duhet të argumentojë zyrtarisht arsyen e vonesës së riparimit dhe me kërkesën e Shoqatës SOSFF detyrohet të verë në dispozicion të Shoqatës një automjet tjetër, deri sa të riparohet automjeti i difektuar.
9. Shërbimet do të kryhen në servisin e operatorit ekonomik fitues dhe në rastet kur automjeti duhet transportuar me karroatrec në qendrën e servisit, shpenzimet për mjetin transportues si dhe transportin, do të përballohen nga ofertuesi brënda çmimit të ofertës.
10. Shërbimi i riparimit do të quhet i kryer, kur ai të miratohet në zëra dhe në cilësi nga përfaqësuesi i Shoqatës, si dhe nga drejtuesi i mjetit të riparuar, të cilët, me firmosjen e proces-verbalit përkatës, së bashku me faturën e shërbimit të kryer, e konsiderojnë të përfunduar shërbimin e riparimit për automjetin përkatës.

Kritere të veçanta për kualifikim:

1. Tabela me të gjitha zërat e riparimit, përfshirë edhe pjesët e këmbimit që do të montohen gjatë riparimit të automjeteve, të kërkuara dhe të paraqitura nga Ofertuesi në shtojcën nr.2 “Oferta financiare“ duhet të plotësohet rigorozisht nga ofertuesi për të gjithë zërat e riparimit që kërkohen. Në këtë tabelë cdo operator është i detyruar të japë cmimin e shërbimit për njësi për të gjithë zërat e tabelës.

Në një automjet ose në të gjithë automjetet mund të ndodhe që disa zëra shërbimi të përsëriten ose mund të mos kryhet asnjë zë riparimi i planifikuar në varesi të difekteve që paraqet automjeti.

Tabela duhet të plotësohet për secilin prej automjeteve të listuara në listën e automjeteve.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij të punësuar në funksion të realizimit të objektit të prokurimit minimalisht jo më pak se 8 (tetë) punonjës, për cdo muaj për periudhën Janar – Dhjetor 2025, nga të cilët në stafin teknik gjatë kësaj periudhe të jenë të punësuar për çdo muaj të paktën 1 (një) inxhinier mekanik të profilit autotransport (mjete lëvizëse) 1 (një) motorrist, 1 (një) pompist, 1 (një) bojaxhi, 1 (një) llamarinist, 1 (një) xhenerik, 1 (një) elektroaut diagnostikues difektesh elektrike, elektronike si dhe të sistemit të injeksionit të ushqimit në motor për automjetet.

Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë:

- Listat e punonjësve me profesionet përkatëse që ushtrojnë si dhe listëpagesat e sigurimeve shoqërore të konfirmuara nga tatimet, për çdo muaj për periudhën Janar – Dhjetor 2025, ku punonjësit me profesionet përkatëse sa më sipër të jenë detyrimisht të pasqyruar në to.

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të provojë se disponon Licencë për ushtrimin e veprimtarisë së riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve, sipas Kodit VII.3.B.1, kategoritë a, b, c, ç, e vlefshme dhe e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), sipas legjislacionit në fuqi. Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht, paisje teknike të nevojshme bashkëkohore për realizimin e kontratës, si vijon:

-Jo më pak se 2 (dy) ura ngritëse.

-Pajisje për kontrollin dhe testimin (diagnostikimin) e sistemit elektrik dhe difekteve në motor të automjetit.

-Pajisje për kontrollin dhe testimin elektronik të sistemit frenimit të automjetit.

-Pajisje për kontrollin & balancimin e disqeve & gomave të automjetit.

-Pajisje për ndërrimin e fluidit (alkoolit) për komplet sistemin e frenimit.

-Pajisje për vënien në fazë të motorrit të mjetit.

-Pajisje për matjen e komprimit të motorëve diezel.

-Pajisje për kontroll të presionit në sistemin e ftohjes së motorrit.

-Pajisje për kontrollin dhe mbushje me gaz të sistemit A/C.

-Kompjuter për diagnostikimin e automjeteve i pajisur me programe për të gjitha llojet e automjeteve (që në disponojme).

Reparti i riparimit karrocisë së automjetit (shasisë, tapicerisë dhe përpunimit të llamarinës) si dhe bojatisjes së mjetit të ketë kapacitetet për realizimin e shërbimeve të mjeteve sikurse kërkohet në zërat e punës të kërkuara në shtojcën nr.2.

Në lidhje me këto kërkesa për pajisje operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë inventarin e mjeteve të sipërcituara me dokumentacionin përkatës që e vërteton atë.

4. Operatori ekonomik duhet të ketë karroatrec për transportimin e automjeteve të difektuara. Në lidhje me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë se ka karroatrec në pronësi ose me kontratë qiraje.
5. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i certifikuar sipas standardit ISO 9001:2015 për aktivitetin e mirëmbajtjes dhe riparimit të automjeteve, ose ekuivalent.
6. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore të tipit B, sipas legjislacionit në fuqi, për aktivitetin e ushtruar.
Në rast se ofron shërbime bojatisjeje të mjeteve, operatori duhet të jetë i pajisur me leje mjedisore përkatëse për këtë aktivitet, ose të paraqesë marrëveshje nënkontraktimi me subjekt të licencuar.
Sa më sipër (pika 3, 5 dhe 6) operatori duhet të paraqesë Certifikatat përkatëse.
7. Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me kamera sigurie të cilat duhet të bëjnë të mundur monitorimin 24 orë të gjithë veprimtarisë së riparimit të automjeteve si dhe në ambjentet e parkimit gjatë qëndrimit të tyre.

Vendi i krverjes së shërbimit:

Brenda territorit të Bashkisë Tiranë, ndërsa për difekte të vecanta ato mund të kryhen në servise të specializuara, por gjithmonë nën përgjegjësinë e operatorit ekonomik fitues.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Bashkëlidhur materialit janë:

Proces-verbali nr. 1 dhe proces-verbali nr. 2.

Proces-verbal nr. 1.
Dorëzimi i automjetit në servis.

I mbajtur sot me datë _____ në ambientet e servisit _____ për përcaktimin e shërbimeve që do të kryhen në automjetin me targë _____ me shofer (drejtues mjeti) _____.

Nga ekzaminimet e kryera në ambjentet e servisit në prani të përfaqësuesit të autorizuar të tij, drejtuesit të mjetit dhe personave të autorizuar të SOSFF u konstatuan difektet me zërat e punës si më poshtë.

Automjeti ka hyrë në servis me datë _____, ora _____.

Në momentin e kontrollit automjeti shënon _____ km.

Nr	Emërtimi i zërit të punës	Njësia	Sasia	Shënime
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				

Përfaqësuesi i SOSFF i autorizuar
për ndjekjen e kontratës

Drejtuesi i Mjetit

Përfaqësuesi i Servisit

Emër Mbiemër
Nënshkrimi

Emër Mbiemër
Nënshkrimi

Emër Mbiemër
Nënshkrimi

Proces-verbal nr. 2
Marrje e automjetit nga servisi

I mbajtur sot me datë _____ në prani të përfaqësuesit të autorizuar të Kompanise (servisit), personit të autorizuar nga Organizata SOSFF dhe shoferit të automjetit (përdoruesit të mjetit) Z. _____ mbi shërbimet e kryera në automjetin tip _____, me targë _____.

Konfirmohet se në automjetin në fjalë janë kryer shërbimet e mëposhtme.

Nr	Emërtimi i zërit të punës	Njësia	Sasia	Shënime
1				
2				
3				
4				
5				
6				
7				

Automjeti ka dalë nga servisi me datë _____, ora _____.

Në përfundim të riparimit automjeti shënon _____ km.

Vërejtje _____

_____.

Përfaqësuesi i SOSFF i autorizuar
për ndjekjen e kontratës

Drejtuesi i Mjetit

Përfaqësuesi i Servisit

Emër Mbiemër
Nënshkrimi

Emër Mbiemër
Nënshkrimi

Emër Mbiemër
Nënshkrimi